



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI**

C.nr.1599/17

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Lumni Sallauka, me sekretaren juridike Raxhije Emiri, në kontestin e paditësit Q. K. nga Prizreni Rr. ... nr. ..., A., të cilin me autorizim e përfaqëson av. E. Gj. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimin e pagave përcjellëse në pension, në mungesë të palës së paditur, me datën **07.02.2018**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Q. K. nga Prizreni, **si e bazuar**.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit Q. K. në emër të pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, t'ia kompensojë (3) tri paga mujore dhe në emër të shpërblimit jubilar t'ia kompensojë (3) tri paga mujore sipas listës së pagave dhe atë në shumë të përgjithëshme prej **2,775.24 €**, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej 259 €, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë të palës së paditur, konform nenit 423 parag.3 të LPK-së.

Paditësi Q. K. nga Prizreni, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në të cilën ka deklaruar se ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, prej nga është pensionuar me stazh të plotë. Me vendimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit Shkences në Prizren, i është ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare (pensionimit). Pas pensionimit me kërkesë i është drejtuar, Komunes së Prizrenit – Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe Shkences në Prizren që në emër të pagave përcjellëse dhe shpërblimit jubilar për pension, konform nenit 53 të kontratës kolektive të vitit 2015 t'ia paguajë tri paga për shkuarje në pension si dhe shpërblimin jubilar. Pasi që e paditura nuk i

ka respektuar dispozitat ligjore për pagesën e kërkuar, paditësi kërkonë nga gjykata që kërkesëpadinë e tij ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

E autorizuar e paditësit av. E. Gj. gjatë shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke kërkuar nga gjykata që ta aprovojë të njejtën në tërësi si të bazuar. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar: për padi 104 €, për taksë gjyqësore për padi në shumë prej 20 €, si dhe për pjesmarrje në një seancë gjyqësore 135 €.

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në munges të palës së paditur, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë. E njehta përmes përgjigjes në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit Q. K. në tërësi, pasi me vet faktin Marrëveshja e Përgjithëshme Kolektive e parasheh pagesën e tre pagave me rastin e pensionimit. Komuna e Prizrenit nuk mund ta kryej një kompensim të tillë për punëtorët e saj. Marrëveshjen e përgjithëshme Kolektive nuk po e njeh Ministria për Financa, respektivisht nuk ka filluar së zbatuari këtë marrëveshje, sepse me arritjen e moshës së pensionimit punëtorët dalin nga sistemi i pagave automatikisht dhe njëherësh një kompensim i tillë është i përealizueshëm nga ana e Komunës së Prizrenit. Komuna nuk ka mundësinë e ndërhyrjes në listat e pagave pasi ajo është në kompetencë të Ministrisë për Financa. Për këto arsye ka kërkuar refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit Q. K. si të pabazuar.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike gjykata ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova: Vendimin me nr.1323 të datës 30.06.2017, të lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren; leximin e vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale – Departamenti i Pensioneve lidhur me miratimin e kërkesës së paditësit i datës 18.10.2017, pasqyrën e llogarisë bankare të datës 30.08.2017, të lëshuar nga Procredit Bank, përgjegjën e të paditurës dhënë paditësit për konpenzimin e pagave jubilarë dhe përcjellse për dalje në pension nr. 2523/17 i datës 01.12.2017, vendimin e inspektoriatit të punës nr. 2213/17, i datës 17.10.2017.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është **e bazuar**.

Nga leximi i vendimit me nr.1323/7 të datës 30.06.2017, të lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, është vërtetuar fakti se i është ndërprerë përfundimisht marrëdhënia e punës paditësit për shkak të arritjes së moshës së pensionit me datën 20.09.2017.

Nga leximi i pasqyrës së llogarisë bankare të datës 03.08.2017, të lëshuar nga Procredit Banka, për këtu paditësin Q. K., gjykata ka konstatuar që të ardhurat për tre muajt e fundit për paditësin kanë qenë në shumën prej 462.54 €.

Nga leximi i përgjigjes në kërkesën e paditësit Q. K., të të paditurës Drejtorisë Komunale për Arsim dhe Shkencë nr. 2533 i dt. 01.12.2017, për konpenzimin e pagave jubilarë dhe përcjellse të kërkuara, vërtetohet fakti se kërkesa e paditësit është refuzuar si e pa bazuar.

Nga leximi i vendimit nr. 2213 i dt. 17.10.2017, të lëshuar nga Inspektoriati i punës, gjykata konstatoi faktin se këtu paditësit Q. K. i është miratuar kërkesa për njohjen e të drejtës për realizimin e pagave përcjellëse për pension dhe pagave jubilarë.

Në nenin 4 par.2 të Ligjit të Punës (Nr.03/L-212) i cili ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditësve parashihet se *“Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”*. Ndërsa në nenin 67 të këtij ligji parashihet se *“1.Kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet: 1.4. kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeq”*. Poashtu në nenin 90 të këtij ligji parashihet se *“1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit,2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes.3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”*.

Poashtu në nenin 52 parag. 1.3 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015, parashihet se puntorit I takon shpërblimi jubilar *“për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë të punëdhënësi I fundit, në vlerë të tri pagave mujore të tij”*, ndërsa neni 53 thot *“I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt te fundit”*.

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi tek e paditura kanë qenë në marrëdhënie pune, e caktuar në vendin e punës – mësimdhënës në SHFMU “Ibrahim Fehmiu” në Prizren. Me vendimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren, të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare (pensionimit).

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet në tërësi. Kjo ngase në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura deri me 20.09.2017, kur të njëjtit me vendim të të paditurës i është ndërprerë kontrata e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionit. Më pas, paditësi i është drejtuar organeve të të paditurës në procedurë administrative për kompensimin e pagave për shkak të shkuarjes në pension dhe pagave jubilarë, mirëpo ka marr përgjigje negative. Kjo është vërtetuar në bazë të provave të administruara e sidomos (vendimit për pensionimin e këtu paditësit). Në rastin konkret gjykata gjatë vendosjes lidhur me këtë çështje juridike vlerësoi dispozitat ligjore të cekura në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, ku në neni 3 është paraparë se *“dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës”*, ndërsa në nenin 4 është paraparë se *“dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit*

të cilët në çfarëdo mënyre kryejnë veprimtari ekonomike, jo ekonomike dhe shërbime civile. Poashtu në nenin 52 është paraparë e drejta për paga jubilarë dhe në nenin 53 të kësaj kontrate është paraparë se i punësuar, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt te fundit. Andaj, provave të lartcekura gjykata ua fali besimin e plotë, ngase gjeti se të njëjtat janë të besueshme dhe përputhen në tërësi me gjendjen faktike të vërtetuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Si përfundim gjykata vlerësoi se kjo e drejtë i takon paditësit në kuptim të dispozitave të lartcekura, për çka dhe vendosi që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësit t'ia paguajë tri paga në emër të shpërblimit jubilar (mbi 30 vite përvoj pune, e cila është konstatuar edhe në vendimin e inspektoratit të punës të cekur më lartë) tri paga për përcjellje në pension në lartësi të tri pagave të fundit të cilat i kanë realizuar këtu paditësit (paga mujore në shumë prej 462.54 €).

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e pagave të cilën paditësi e ka realizuar në tre muajt e fundit para pensionimit, mori parasysh listen e pagave, ku Gjykata konstatoi se të njëjtit i takon shuma e përgjithshme prej 2,775.24 €, neto pasi paga e tij në 3 muajt e fundit para pensionimit ka qenë 462.54 €. Kjo çështje nuk është kontestuar nga ana e palës së paditur përmes përgjigjës në padi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësit t'ia paguajë shumën prej 259 €, për shpenzimet gjyqësore dhe ate: për padi 104 €, për taksë gjyqësore shumë prej 20 €, për një séance gjyqësore 135 €.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konformë nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.1599/2017, datë 07.02.2018

Sekretarja juridike,
Raxhije Emini

Gjyqtari,
Lumni Sallauka

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.